



Pranuar / Dorezuar Puniljeno / Prodato Received / Delivered	14. 01	2021	1	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinita Org./Unit	SKIMBAC	150/2021	Shtesa e Frygje Appendix	Sasia Kohësuna Quantity
				114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.382/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave i përbërë nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.382/2020, të datës 01.12.2020, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr.“Ilir Konushefci” Komuna e Podujevës, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “Kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datën 14.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.382/2020 e datës 01.12.2020 e parashtruar nga ankuesi

II. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke bërë kompensimin e një shume monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, për ankuesin

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunës Administrativ pran Qendrës së Regjistrimit të Automjeteve në Podujevë - Agjencia e Regjistrimit Civil, me datë 01.12.2020 ka parashtruar ankesën me numër protokollit 2868/2020 të regjistruar me numër A.nr.382/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim

Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që t'i njihet e drejta e kompensimit të një shume monetare në vlerën e një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, për rastin e vdekjes se anëtarit të familjes (vëllaut).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datën 03.12.2020, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Këshilli, me datë 14.12.2020 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme, bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.382/2020 të datës 01.12.2020 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim civil të Kosovës: Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 03.12.2020 me numër të protokollit 2926/2020: Përgjigjen në ankesë të datës 14.12.2020 me numër të protokollit 3120: Emalin e datës 01.12.2020: Emalin e datës 03.11.2020: Emalin e datës 09.10.2020: Emalin e datës 10.09.2020: Akt Emërimin e datës 01.02.2013 me numër Ref: DRGJC/ARC-04/13: Kërkesën e datës 07.09.2020 për kompensimin për rastin e vdekjes të anëtarit të familjes: Certifikatën e Vdekjes V 10359655 të datës 21.10.2020: Emalin e datës 06.01.2021: Deklaratën e Bashkësisë Familjare me numër F 11021838 të datës 06.01.2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e bazuar, *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, përkatësisht Akt Emërimin me Nr.Ref:DRGJ/ARC 04/13 të datës 31.01.2013, Kolegji ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës "Nëpunës Administrativ" pranë QRKC në Podujevë - Agjencia e Regjistrimit Civil.

Ankuesi me datë 07.09.2020 përmes kërkesës me numër të protokollit 197/2020, i është drejtuar Menaxheres së Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, duke kërkuar kompensimin e një shume monetare në vlerën e një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, për rastin e vdekjes se anëtarit të familjes, vëllaut,

Ministria e Punëve të Brendshme, respektivisht Drejtori i Drejtoratit për Pajisje me Dokumente në Agjencinë e Regjistrimit Civil, duke iu referuar Opinionit Ligjor të datës 09.10.2020 të lëshuar nga Departamenti Ligjorë i Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datë 03.11.2020 përmes e-mailit zyrtar, ka njoftuar ankuesin se me rastin e vdekjes se vëllait apo motrës, te cilët nuk jetojnë në bashkësi familjare, nëpunësit civil nuk i takon kompensimi.

Ankuesi në ankesën e dorëzuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, pretendon se Ministria e Punëve të Brendshme, me rastin e refuzimit të kërkesës se tij për kompensim e një shume monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, për rastin e vdekjes se vëllaut, gabimisht ka zbatuar dispozitat materiale, sepse kjo e drejte është e garantuar me dispozitat e nenit 22 paragrafi 2 nen paragrafi 2.4 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, si dhe nenin 22 paragrafi 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil.

Lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 22, ku përcaktohet se: 2. *Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim; 2.4 ndihma në rast të vdekjes së nëpunësit ose vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes së tij/saj dhe ndihmë familjes në rast të vdekjes së nëpunësi civil; si dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 22, ku përcaktohet se: 2. Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, në rast të vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes së tij/saj, institucioni ndihmon nëpunësin civil me një shumë monetare me vlerë prej një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, dhe si rrjedhojë Kolegji ka konstatuar se nëpunësi civil gëzon të drejtën e ndihmës institucionale, përmes realizimit të një shume monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes.*

Se kush përbën familjen, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, vlerëson se duhet të merret për bazë përkufizimi i dhënë në Ligjin Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, përkatësisht neni 1 dhe 2 të këtij Ligji, që jep përkufizimin e familjes, si dhe neni 271 ku përcaktohet se: *Bashkësia familjare përfshin bashkëshortët dhe familjen e tyre të ngushtë, që në këtë Ligj përfshijnë fëmijët dhe prindërit e bashkëshortëve. Personat tjerë të afërm të familjes si dhe personat të cilët kryesisht janë të varur ekonomikisht dhe të cilët jetojnë në shtëpi të përbashkët me bashkëshortët, mund të konsiderohen anëtarë të bashkësisë familjare për qëllimet e këtij ligji. Çështja e përkufizimit të familjes sipas dispozitave të Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, për qëllim të kompensimit të nëpunësve civil, me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes, është konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit e Kosovës, në Aktgjykimin A.A.nr.14/2017.*


Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke u bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Certifikatën e Vdekjes V 10359655 të datës 21.10.2020, të dorëzuar nga ankuesi, ka konstatuar se Ahmet Mulliqi, gjegjësisht vëllau i ankuesit, ka ndërruar jetë me datë 15.08.2020, ndërsa bazuar në Certifikatën e Bashkësisë Familjare F 11021838, Kolegji ka konstatuar se vëllau i ankuesit, tani i ndjeri ka qenë duke jetuar në bashkësi familjare me ankuesin.

Andaj, duke iu referuar nenit 22 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, nenit 22 paragrafi 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, si dhe nenit 1, 2 dhe 271 të Ligjit Nr.2004/32 për Familjen në Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për kompensimin e një shume monetare në vlerë të një page mesatare në Shërbim Civil, për rastin e vdekjes së vëllaut, është i bazuar.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën



i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.382/2020.

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Jeton KOÇA
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së